

Raporti nga monitorimi i raportimit mediatik për punën e Kuvendit

(janar - prill 2016)

*Ky publikim është i përgatitur me ndihmë të agjencisë Zvicerane
për përkrahje dhe zhvillim.*

*Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi e vetme e Institutit për
demokraci “Societas civilis” – Shkup (IDSCS) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të
konsiderohet se i reflekton pikëpamjet e agjencisë Zvicerane për përkrahje dhe
zhvillim.*



Instituti për demokraci “Societas Civilis” Shkup (IDSCS) nga qershori i vitit 2014 e përcjell cilësinë e debatit në Kuvendin. Monitorimi në ciklin e parë u zhvillua gjatë 10 muajve, përkatësisht nga qershori i vitit 2014 deri në maj të vitit 2015¹. Nga shtatori i vitit 2015 monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë së debatit parlamentar vazhdon i përkrahur nga Agjencia zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim dhe do të zgjas deri më dhjetor të vitit 2017.

Qëllimi i monitorimit të medieve është për të ardhur në njohuri se në të cilën masë mediet janë pjesë e procesit të deliberacionit në shoqërinë gjatë krijimit të politikave publike, përkatësisht se në çfarë mase opinionit më të gjerë i ja transmetojnë argumentet e shfaqura në debatet kuvendore.

Para jush është raporti i dytë për raportimit mediatik për Kuvendin që ka të bëjë me periudhën katërmujore prej 1 janari deri më 6 prill të vitit 2016.

Rezyme

- Në këtë periudhë (janar-prill 2016) për herë të parë nga fillimi i monitorimit (qershor 2014) të raportimit mediatik për Kuvendin, mediet kanë publikuar më tepër informacione në të cilat si burime janë përfaqësuar në të njëjtën kohë deputetë edhe nga shumica edhe nga opozita (51%) se sa vetëm me deputetë nga një opion politik (49%).
- Në informacionet e publikuara me deputetë nga vetëm një opion politik, më të përfaqësuar janë deputetët nga shumica në të cilët shkojnë 57% të rasteve të tilla. Në informacione në të cilat janë përfshirë vetëm deputetë nga opozita shkojnë 43%.
- Informacionet në të cilat në të njëjtën kohë janë theksuar deputetë edhe nga pushteti edhe nga opozita kanë të bëjnë me debatet në seancat plenare dhe seancat e komisioneve kuvendore.
- Ngjarjet politike jashtë Parlamentit sërish ishin në fokus të interesit mediatik. Mediet më shpesh e përmendnin Kuvendin në kontekst të ngjarjeve të tjera politike në shtet (47%), ndërsa më pak rreth përmbajtjes së debateve parlamentare dhe punës së deputetëve (32%).
- Nga seancat e komisioneve, në fokusin mediatik më shpesh ishin diskutimet e Komisionit për arsim dhe shkencë, Komisionit për sistem politik dhe marrëdhënie midis bashkësive, Komisionit për mbikëqyrje të punës së Drejtorisë për siguri dhe kundër-zbulim, Komisionit anketues për skandalin me fabrikën për falsifikim të letër njoftimeve, pasaportave, aferave dhe dokumenteve të tjera dhe Komisionit për çështje evropiane.
- Deputetët sërish janë burime më shpesh të theksuara në informacionet (40%), por përqindja ka rënë për 9% krahasuar me periudhën paraprake të monitoruar (shtator-dhjetor 2015 –

¹ Cikli i parë i cilësisë së debatit dhe të raportimit mediatik u zhvillua në kuadër të projektit “Kuvendi nën thjerrëz. Përforcimi i debatit politik dhe i diskursit deliberativ” i financuar nga Instrumenti Evropian për demokraci dhe të drejtat e njeriut – EIDHR dhe i bashkë-financuar nga IDSCS dhe IEKOB. Raportin e plotë për cilësinë e debatit në ciklin e parë të vëzhguar i cili e përfshiu periudhën nga qershori i vitit 2014 deri në maj të vitit 2015 është i qasshëm në linkun vijues: <http://idscs.org.mk/images/parliament-watchdog/rovovska-debata-mk.pdf>

49%). Në llogari të kësaj u rrit përfaqësimi i burimeve nga parti politike, institucione publike dhe të organizatave civile.

- Më të shumta janë informacionet në të cilat është theksuar vetëm një burim (30%), mandej ato me dy (29%), ndërsa në këtë periudhë është rritur përqindja në të cilat janë dhënë tre dhe më shumë se tre burime në të cilat bashkë shkojnë 34%.
- Informacionet e publikuara që kanë të bëjnë me Kuvendin më shpesh janë të strukturuar si raporte informative (60%), ndërsa në këtë periudhë është rritur numri i shkrimeve të cilat krahas informacioneve përmbajnë edhe elemente analitike (19%). Lajmet e shkurtra vetëm me informacione themelore për ngjarjet janë të tretat sipas përfaqësimit (18%).
- Mediet në gjuhën shqipe në përgjithësi më shpesh publikonin informacione të ndërlidhura me Kuvendin. Me këtë rast, pjesa më e madhe e informacioneve kanë të bëjnë me përmbajtjen e debateve të komisioneve, mandej informacione në të cilat Kuvendi vetëm përmendet ose që kanë të bëjnë në përgjithësi me punën e parlamentit dhe rreth ndryshimeve dhe hyrjes në fuqi të ndryshimeve të një ligji konkret. Mediet në gjuhën maqedonase publikonin më shpesh informacione që kanë të bëjnë me diskutimet në seancat plenare të Kuvendit.

I. Konteksti politik

Në pajtim me Kushtetutën, Kuvendi e ka pushtetin ligjvënës dhe është i përbërë nga 123 deputetë. Deputetët zgjedhen në zgjedhje të drejtpërdrejta, përmes listave proporcionale zgjedhore për mandat prej katër vitesh. Në zgjedhjet e fundit parlamentare, të mbajtura në prill të vitit 2014, partia Organizata e brendshme revolucionare maqedonase – Parti demokratike për unitet kombëtar maqedonas (VMRO – DPMNE) fitoi 61 deputet ndërsa partneri i tyre i koalicionit me të cilin e themeluan Qeverinë, Bashkimi Demokratik për integrim (BDI), fitoi 19 deputetë. Nga një deputet në Kuvendin fituan partitë e Opsionit qytetar për Maqedoninë (GROM) dhe Rilindja demokratike kombëtare (RDK). Deputeti i cili mandatin e vet e fitoi nga RDK edhe krahas vendimit të partisë që ta bojkotojë Kuvendin iu bashkëngjiti grupit të deputetëve të BDI-së. Deputeti i BDI-së, Zulfi Adili, në shtator paralajmëroi se e braktis grupin parlamentar dhe se do të vazhdojë të merr pjesë në punën e Kuvendit si deputet i pavarur. Me këtë grupi i deputetëve i BDI-së numëron 19 deputetë. Me atë, tani grupi i deputetëve i BDI-së numëron 20 deputetë. Më 8 maj partia Përtëritja demokratike për Maqedoninë (DOM) e cila ka një deputet (Liljana Popovska) në Kuvendin, vendosi ta braktis koalicionin pushtet-mbajtës. Në periudhën nga 20 qershori i vitit 2014 deri në fund të gushtit të vitit 2015, deputetët e koalicionit më të madh opozitar të udhëhequr nga Lidhja socialdemokrate e Maqedonisë (LSDM), e cila në zgjedhjet fitoi 34 mandate, e bojkotoi punën e Kuvendit. Nga 1 shtatori i vitit 2015 deputetët e koalicionit të LSDM u kthyen në parlamentin dhe morën pjesë në punën e tij.

Partitë më të mëdha nga pushteti dhe opozita pas periudhës së vullshme të krijuar pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në prill të vitit 2014 në të cilën u publikuan një varg skandalesh të ndërlidhura me përgjimin e paligjshëm dhe në të cilën ndodhën protesta, më 2 qershor me ndërmjetësim të komisionarit për zgjerim të UE Johanesh Han arritën marrëveshje² për tejkalimin e krizës. Marrëveshja përmban një varg masash me afate konkrete të cilat duhet të ndihmojnë që të tejkalohej kriza politike e cila u zhvillua pas shpalljes së bisedave të përgjuara. Masat kanë të bëjnë me kthyerjen e opozitës në Kuvendin, organizimin e zgjedhjeve të reja parlamentare, dorëheqje të qeverisë aktuale, formimin e qeverisë në të cilën në resorë kyç do të emërtohen ministra nga opozita,

² Marrëveshja në opinionin e fitoi emrin "Marrëveshja e Përzihos" sipas lagjes në Shkup në të cilën është e vendosur rezidenca e UE në të cilën u zhvilluan negociatat politike midis liderëve të katër partive më të mëdha politike në Maqedoni, VMRO – DPMNE, LSDM, BDI dhe PDSH.

reforma në legjislativin zgjedhor, themelimin e prokurorisë speciale publike me mandat që ti hetojë theksimet në incizimet e publikuara.

Ndërkohë, ekipi i ekspertëve i angazhuar nga Komisioni evropian i udhëhequr nga Rajnhard Pribe, drejtor i mëparshëm i Drejtorisë për Ballkanin Perëndimor në Komisionin Evropian përgatiti raport të detajuar për problemet në më tepër sfera. Raporti i bën vështrim sistemit gjyqësor, kontrollit të punës së shërbimeve të sigurisë, problemeve gjatë organizimit të zgjedhjeve, gjendjes në mediet dhe udhëzime për reforma në të gjitha këto fusha e qëllimi i kësaj është përmirësimi i gjendjes në të gjitha fushat. Raporti i është dërguar Kuvendit dhe shërben si udhërrëfyes për zbatimin e reformave në sferat e theksuara.

Nga 1 shtatori i vitit 2015 opozita e udhëhequr nga LSDM u kthye në Kuvendin. Në periudhën e monitoruar janar – prill të vitit 2016 shumica në pushtet në Kuvendin numëron 81 deputet, ndërsa opozita 42 deputetë.

Në tetor të vitit 2015, në pajtim me Marrëveshjen, opozita morri poste ministrore në qeverinë e Gruevskit në ministritë e punëve të brendshme dhe të punës e politikës sociale. Zëvendës ministra opozitarë janë vendosur në Ministrinë për financa dhe atë të bujqësisë për ta kontrolluar punën e institucioneve kyçe shtetërore në periudhën deri në zbatimin e zgjedhjeve. Nga 14 janari i vitit 2016 në krye të Qeverisë është i ashtuquajti kryeministër “teknik” Emil Dimitriev në vend të liderit të VMRO-DPMNE-së, Nikolla Gruevski.

Partitë me një varg zvarritje në negociatat që zhvilloheshin midis grupeve të tyre të punës në Klubin e deputetëve me ndërmjetësim të ndërmjetësit Piter Vanhoute të angazhuar nga UE dhe SHBA, i tejkaluan afatet paraprakisht të kontraktuara për zbatimin e reformave. Negociatat në sferën e jurisprudencës dhe mediet u ndërpre në duke mos u arritur marrëveshje. Për shkak të një numri të madh të mos-pajtimeve në procesin politik, më 6 prill të vitit 2016 ministrat dhe zëvendës-ministrat e LSDM-së paraqitën dorëheqje në funksionet e veta në Qeverinë të cilat formalisht nuk u shqyrtuan dhe nuk u votuan nga Parlamenti. Më 8 prill, Qeveria e Emil Dimitrievit pa praninë e funksionarëve nga LSDM, i suspendoi vendimet e tyre të deri atëherëshme.

Më 24 shkurt të vitit 2016 Kuvendi votoi shtyrje të zgjedhjeve për 5 qershor për shkak të mos-përbushjes së një pjese të kushteve të parapara me “Marrëveshjen e Përzhinos”. Më 6 prill shumica pushtetmbajtëse në Kuvendin votoi shpërbërje, me çka filloi të rrjedh afati për organizim të zgjedhjeve të cilat duhej të mbaheshin më 5 qershor. Koalicioni opozitar i udhëhequr nga LSDM, me arsyetim se ende nuk janë përbushur kushtet për organizim të zgjedhjeve fer dhe demokratike, paralajmëruan se nuk do të merr pjesë në zgjedhjet. Kriza politike u thellua në mënyrë shtesë pas shpalljes së abolicionist nga presidenti i shtetit Gjorgje Ivanov më 12 prill të vitit 2016. Ivanov në fjalimin e tij drejtuar kombit pati arsyetim se dëshiron që ta qetësojë krizën dhe shpalli se ka nënshkruar vendime për abonim të 56 personave midis të cilave edhe liderët e partive më të mëdha, Nikolla Gruevski i VMRO-DPMNE-së dhe Zoran Zaev i LSDM-së. Abolimi që e shpalli Ivanov shkaktoi protesta masive në Shkup dhe më tepër qytete nëpër shtet me të cilat u kërkua dorëheqja e tij dhe tërheqje e vendimit me qëllim që të gjitha rastet që i inicion PSP të mund të procesohen në mënyrë përkatëse

Periudha e gjithëmbarshme e monitorimit e mbuluar me këtë raport katër-mujor (dhjetor 2015 – prill 2016) kaloi në shenjën e polarizimit të fuqishëm politik midis dy partive më të mëdha VMRO-DPMNE dhe LSDM, si pasojë e rezultatit të pasuksesshëm të negociatave për dalje nga kriza politike.

II. Gjetje nga monitorimi

- **Fokusi i informacioneve të publikuara**

Në periudhën e monitoruar nga 1 janari deri më 6 prill të vitit 2016 janë identifikuar dhe analizuar 447 informacione të publikuara në mediet e monitoruara në të cilat përmendet Kuvendi ose deputetët. Analiza e këtyre përmbajtjeve vë në pah se mediet në këtë periudhë më shpesh, krahasuar me periudhën paraprake (shtator-dhjetor 2015) publikon informacione në të cilat i bëjnë vështirë Kuvendit në kontekst të çështjeve të tjera politike, ndërsa më pak fokusohen në debatin për ligjet ose ngjarjet në seancat kuvendore.

Në 47% të informacioneve Kuvendi vetëm përmendet në kontekst të ngjarjeve të tjera politike në shtet, ose informacionet në përgjithësi kanë të bëjnë me raportet e partive politike në parlamentin.

Në llogari të kësaj, u zvogëluar mbulimi mediatik i debateve parlamentare dhe diskutimet rreth ligjeve dhe akteve të tjera që ishin në rendin e ditës të Kuvendit. Në periudhën janar – prill 2016 në debatet në seancat plenare dhe në komisionet kanë të bëjnë gjithsej 32% nga informacionet e monitoruara mediatike. Ajo është 11% më pak krahasuar me periudhën paraprake të monitoruar shtator – dhjetor 2015. Ajo do të thotë se vëmendja mediatike u ri-orientua nga debatet parlamentare drejt ngjarjet e tjera politike në shtet si zgjedhjet e parakohshme dhe shpërbërja e prolonguar e Kuvendit, ndërrimi i ministrave të BDI-së në Qeverinë, negociatat midis partive në Klubin e deputetëve, puna dhe rastet që i hapi Prokuroria Speciale publike, si dhe vizitat e diplomatëve të huaj në drejtim të ç'thurjes së krizës politike.


Gjatë raportimit nga diskutimet në seancat parlamentare mediet më shpesh u fokusuan në seancat me konfrontim më të fuqishëm politik dhe atmosfera e polarizuar midis deputetëve të blloqeve të kundërshtuara politike. Në fokusin mediatik më shpesh ishin seancat e Komisionit për arsim dhe shkencë rreth debatit për themelimin të Universitetit Damjan Gruev, Komisionit për sistem politik dhe marrëdhënie midis bashkësive, Komisionit për mbikëqyrje të Drejtorisë për siguri dhe kundër-zbulim dhe Agjencisë për zbulim, Komisionit anketues për skandalin me fabrikën për falsifikimin e letër njoftimeve, pasaportave, afera dhe dokumente të tjera dhe Komisionit për çështje evropiane.

Fokusi in informacioneve të publikuara është prezantuar përmes resë semantike nga njëqind fjalët më shpesh të përdorura nga mediet në titujt dhe nëntitujt e gazetave dhe në paralajmërimet e kontributeve televizive në të cilat përmendet Kuvendi.




Grafiku: Reja semantike nga 100 fjalët me frekuente (të shpeshta) të përdorura në titujt, nën-titujt dhe paralajmërimet në mediet që kanë të bëjnë me Kuvendin të publikuara në periudhën janar – prill 016.

Pothuajse njëloj me periudhën paraprakisht të monitoruar mbetën të përfaqësuara informacionet në të cilat vihet në pah ndryshimi ose shlyerja e ligjeve ekzistuese ose hyrja në fuqi të ndryshimeve të reja ligjore – 13%. E njëjtë është gjendja edhe me informacionet në të cilat deputetët komentuan ngjarje të tjera jashtë nga Kuvendi -7%.




Nëse analizohet fokusi i informacioneve sipas gjuhës së medias e cila e ka publikuar rezulton se mediet në gjuhën shqipe me shpesh kanë publikuar informacione në të cilat Kuvendi vetëm përmendet ose kanë të bëjnë në përgjithësi me Kuvendin, por përmbytja nuk ka të bëjë me punën e deputetëve, por, me ngjarje më të gjera politike dhe raporte në shtetin. Mediet në gjuhën maqedonase me shpesh publikuan informacione për diskutimin kuvendor në seancat plenare, ndërsa mediet në gjuhën shqipe për seancat e komisioneve kuvendore. Informacionet në të cilat deputetët komentojnë ngjarje të tjera jashtë nga Kuvendi janë më të përfshira në mediet që publikojnë në gjuhën shqipe si dhe informacionet që kanë të bëjnë me ndryshimin e një ligji ose hyrjes në fuqi ose shlyerjes së disa dispozitave ligjore.




- Numri dhe ana e burimeve**

Në pothuajse një të tretën (33%) të informacioneve të identifikuara të publikuara në mediet në periudhën janar-prill 2016, e të cilat kanë të bëjnë me Kuvendin është theksuar vetëm një burim. Në 29% janë theksuar dy burime, në 18% tre, ndërsa në 16% më tepër se tre burime. Në 5% të informacioneve nuk është theksuar asnjë burim, ndërsa në 2% nuk ka mund të përcaktohet cilët dhe sa burime janë konsultuar. Ajo do të thotë se në këtë periudhë të monitoruar është shtuar përqindja e informacioneve në të cilat janë theksuar tri ose më tepër burime krahasuar me periudhën paraprake shtator-dhjetor 2016.




Në 40% nga informacionet e publikuara në këtë periudhë si burime janë theksuar deputetë të Kuvendin. Ajo është për 9% më pak krahasuar me periudhën paraprake shtator-dhjetor 2015. Për llogari të kësaj, në periudhën janar-prill 2016 si burime më shpesh janë konsultuar partitë politike ose anëtarët e tyre – 14%. Është rritur përqindja e burimeve edhe nga institucionet publike në të cilat shkojnë 12% nga numri i tërësishëm i burimeve të theksuara. Gjithashtu, në këtë periudhë është rritur përqindja e informacioneve në të cilat në kontekst të Kuvendit janë konsultuar burime nga organizatat civile prej 2% (periudha shtator-dhjetor 2015) në 5%. Burime si janë shënuar si “të tjera”, ndërsa në të cilat hyjnë përfaqësues të shteteve të tjera, të Unionit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ambasadorë në Maqedoni dhe përfaqësues të institucioneve të tjera të jashtme janë theksuar në 11% të informacioneve të publikuara në të cilat është përmendur Kuvendi.




Nëse analizohet cilit opzion politik në parlamentin i takojnë deputetët që janë përmendur si burime, rezulton se për herë të parë nga fillimi monitorimit të tillë në mediet (nga qershori 2014) në pjesën më të madhe të informacioneve janë përfshirë në të njëjtën kohë deputetë edhe nga shumica edhe nga opozita (gjithsej 51%). Në periudhën e kaluar të monitoruar (shtator-dhjetor 2015) të tilla ishin 44% nga informacionet në të cilat si burime ishin të theksuar deputetë.

Në informacionet në të cilat janë të përfaqësuar deputetë nga vetëm një opzion politik shkojnë 49% nga rastet. Prej tyre, mediet më shpesh publikojnë informacione në të cilat janë të pranishëm vetëm deputetë nga shumica – 57%, ndërsa më rrallë vetëm me deputetë nga opozita – 43%. Përfaqësimi i tillë në periudhën janar-prill 2016 dallon nga ajo e konstatuar në periudhën e monitoruar paraprake shtator-dhjetor 2015. Atëherë gjendja ishte e kundërt, përkatësisht, në informacionet në të cilat ishin konsultuar vetëm deputetë nga një opzion politik më të përfaqësuar ishin ato në të cilat ishin të theksuar vetëm deputetë nga opozita.




Përfaqësimi i deputetëve sipas fokusit të informacionit të publikuar rezulton se deputetët nga pushteti dhe nga opozita në të njëjtën kohë janë theksuar si burime në informacionet të cilat kanë të bëjnë me debatet parlamentare në seancat e komisioneve – 86% dhe në seancat plenare - 71%. Në pjesën më të madhe të informacioneve në të cilat vetëm përmendet, ose kanë të bëjnë në përgjithësi me punën e parlamentit janë theksuar deputetë vetëm nga një opzion politik. Me këtë rast deputetët nga pushteti janë më të përfaqësuar në informacionet që kanë të bëjnë në përgjithësi me punën e Kuvendit. Në pjesën më të madhe të informacioneve në të cilat deputetët komentojnë ngjarje të tjera që nuk janë të lidhura me Kuvendin janë përfaqësuar vetëm deputetë nga pushteti – 64%. Në pjesën më të madhe të informacioneve që kanë të bëjnë me hyrjen në fuqi ose shlyerjen e një ligji të caktuar ose ndryshime ligjore janë përfaqësuar vetëm deputetë nga opozita – 52%.



• Zhanri i informacioneve të publikuara

Nga informacionet e analizuar në të cilat përmendet Kuvendi të publikuara në mediet e monitoruara në periudhën janar – prill 2016 pjesa më e madhe janë të strukturuar në formë të raporteve informative nga ngjarjet. Të tilla janë 60% nga informacionet e publikuara. Në to më shpesh transmetohen informacione për ngjarje duke mos u bërë analizë ose duke mos hyrë në kontekstin më të gjerë të ngjarjeve ose të jepet pasqyrë komparative ose historike. Sipas karakteristikave të zhanreve në vend të dytë sipas përfaqësimit janë lajmet e shkurtra (18%) në të cilat vetëm theksohen informacionet e shkurtra për ngjarjet. Mandej vijojnë shkrimet në gazetatat ose temat në televizionet (19%) në të cilat krahas elementeve informative janë përfaqësuar edhe elemente analitike. Komentet, intervistat dhe analizat si zhanre gazetareske janë të përfaqësuara në sasi shumë të vogël gjatë raportimit për punën dhe ngjarjet në Kuvendin. Në disa prej këtyre zhanreve shkojnë nga 1% nga numri i tërësishëm i informacioneve të publikuara.



III. Metodologjia e hulumtimit

Monitorimi i medieve përfshin përcjellje të informacioneve të paraqitura në 10 medie kombëtare në të cilat deputetët dhe Kuvendi. Përcjellja i përfshin tekstet e botuara në gjashtë gazeta ditore nga të cilat katër janë në maqedonisht dhe dy në gjuhën shqipe. Nga kontributet televizive përcillen informacionet e transmetuara në emisionet qendrore informative në katër televizione kombëtare nga

të cilat dy janë në gjuhën maqedonase, ndërsa dy janë në gjuhën shqipe. Me monitorimin janë përfshirë mediet vijuese:

Gazeta

- Dnevnik
- Utrinski vesnik
- Veçer
- Sloboden pečat
- Koha
- Lajm

Televizione

- Sitell
- Tellma
- Alsat-M
- RTM2 Programi në gjuhën shqipe

Në mediet e përmendura përcillen dhe analizohen informacionet në të cilat përmenden Kuvendi, deputetët dhe procedura ligjvënëse. Në çdo tekst veç e veç dhe në çdo kontribut televiziv analizohen elementet kryesore përkatësisht zhanri, fokusi i informacionit, lloji, numri, pala dhe sheshtësia e burimeve

IV. Struktura mediatike dhe gjuhësore e publikimeve


Struktura e përmbajtjeve mediatike të analizuar në periudhën shtator-dhjetor të vitit 2015 është me sa vijon:

Sipas llojit të medias: gazeta ditore 57%, televizione 43%

Gjuha e publikimit: shqip 59%, maqedonisht 41%

Informacione në gazeta sipas gjuhës: shqip 59%, maqedonisht 41%

Informacione në televizione sipas gjuhës: shqip 59%, maqedonisht 41%



Projekti Kuvendi nën thjerrëz

Projekti “Kuvendi nën thjerrëz” është i financuar nga Agjencia zvicerane për përkrahje dhe zhvillim. Në pjesën e aktiviteteve përfshin monitorim 28 mujor të cilësisë së debatit kuvendor dhe monitorim të asaj se si mediet raportojnë për punën e Kuvendit.

Monitorimi i debatit kuvendor dhe i raportimit mediatic filloi në shtator të vitit 2015 dhe do të zgjas deri në dhjetor të vitit 2017 dhe do të përfshijë analizë dhe raportim për njohuritë e përfituara nga monitorimi në çdo tre muaj. Në periudhën e projektit do të përpilohen 9 raporte tremujore për cilësinë e debatit në parlamentin dhe 9 raporte tremujore për raportimin mediatic për punën e deputetëve. Në kuadër të projektit do të zbatohen dhe do të shpallen rezultatet e dy hulumtimeve në terren të opinionit publik për perceptimet e qytetarëve për punën e Kuvendit.

Projekti paraqet vazhdimësi të projektit “Kuvendi nën thjerrëz përforcimi i debatit politik dhe diskursi deliberativ” i cili u financua nga Instrumenti Evropian për demokraci dhe të drejtat e njeriut – IEDHR dhe u realizua në periudhën nga muaji shkurt i vitit 2014 deri në tetor të vitit 2015.

Бр. 0804-195/16

Датум. 20.06.2016



Raporti nga monitorimi i raportimit mediatik për punën e Kuvendit

Janar - prill 2016



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Институт за демократија
Социетас цивилис - Скопје